

LIGJ
Nr.8411, datë 1.10.1998

PËR USHQIMET E BLEGTORISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Mbështetja e shtimit të prodhimit të produkteve blegtorale.
2. Sigurimi i cilësisë, sipas standardeve të miratuara, të produkteve shtazore për aq sa ato ndikohen nga ushqimi.
3. Mënjanimi i dëmtimit të shëndetit të kafshëve nga përdorimi i ushqimeve.
4. Mbrojtja nga mashtrimi në prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve për kafshët , të lëndëve shtesë dhe parapërzierjeve.

Neni 2

Fushat e ligjit

Ky ligj zbatohet në:

- a) produkte me origjinë bimore, shtazore e minerare, si dhe në preparatet kimiko-industriale, të cilat, veçmas ose të përziera midis tyre, destinohen për t'u përdorur për të ushqyer blegtorinë;
- b) prodhimin, përpunimin, tregtimin, inspektimin dhe kontrollin e ushqimeve për kafshët

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë ligj termat e përdorur kanë këtë kuptim:

1. Blegtori quhen kafshët dhe shpendët e të gjitha specieve me interes zooteknik.
2. Ushqime për blegtorinë quhen lëndët, të cilat veçmas (ushqime të veçanta), në përzierje me njëra-tjetrën (përzierje ushqimore) ose me lëndë shtesë, në gjendje të pandryshuar ose të përpunuara, janë të përshtatshme si ushqim për blegtorinë, pa rrezikuar shëndetin e saj dhe të konsumatorëve të produkteve blegtorale.
3. Ushqime me origjinë bimore quhen produktet e veçanta, në gjendjen e tyre natyrore ose të konservuar, si dhe nënproduktet e përpunimit industrial të tyre.
4. Ushqime me origjinë shtazore quhen produktet e veçanta shtazore në gjendje natyrore ose të konservuar, si dhe nënproduktet e përpunimit industrial të tyre.
5. Produkte me origjinë minerare quhen lëndë të veçanta minerare ose përzierje të këtyre lëndëve, që destinohen për ushqimin e blegtorisë.
6. Lëndët shtesë ushqimore quhen preparatet që lejohen të përdoren në të ushqyerit e blegtorisë dhe kanë për qëllim të:
 - a) ndryshojnë teknologjikisht pamjen, aromën ose shijen, formën e jashtme ose aftësinë konservuese të ushqimeve;
 - b) ndikojnë në rrugë fiziologjike - ushqimore në prodhimtarinë e blegtorisë;
 - c) mundësojnë parandalimin e sëmundjeve.
7. Parapërzierje quhet përzierja e një ose disa lëndëve shtesë me një ushqim të veçantë ose përzierja e lëndëve shtesë me njëra-tjetrën, të cilat mund të përdoren ose si shtesa për parapërzierjet e

tjera ose si shtesa të veçanta në një racion ushqimor.

8. Lëndë të dëmshme quhen lëndët të cilat përmbahen në ushqim (si përbërës të tij ose ndotës të tij) dhe që mund të keqësojnë shëndetin, prodhimtarinë e kafshëve dhe cilësinë e produkteve shtazore, në përputhje me standardet, kur ato gjenden në këto produkte si mbetje ushqimore të padëshirueshme.

9. Ushqim i medikuar quhen lëndët e përdorura për diagnostikimin, kurimin, trajtimin ose parandalimin e sëmundjeve të kafshët.

10. Etiketë quhet shënimi i fiksuar tek ambalazhi ose kontenieri ku është vendosur për shpërndarje.

11. Mostër quhet kampioni i ushqimit, i marrë nga organet e kontrollit të ushqimit të blegtorisë për analizë, që kryhet sipas metodave të njohura zyrtare.

12. KUB - Komisioni i të Ushqyerit të Blegtorisë.

13. Subjekte, në kuptim të këtij ligji, quhen personat fizikë dhe juridikë të pajisur me leje përkatëse nga Komisioni i të Ushqyerit të Blegtorisë, të cilët prodhojnë, përpunojnë, magazinojnë apo tregtojnë ushqime për blegtorinë.

Neni 4

Dokumentacioni

Subjektet mbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Lloji i dokumentacionit dhe afati i ruajtjes së tij përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 5

Etiketimi dhe shpërndarja

Kërkesat që duhet të plotësohen për etiketimin e ushqimeve të blegtorisë janë si më poshtë:

1. Për ushqimet e ambalazhura në thasë, në etiketë shënohen:

a) emri dhe adresa e prodhuesit ose e personit përgjegjës për shpërndarjen e ushqimit;

b) numri dhe data e licencës;

c) emri i produktit;

ç) pesha neto e kolisë;

d) emri dhe përbërja në përqindje e të gjithë komponentëve;

dh) specia, grupmosha dhe rendimenti i kafshëve dhe shpendëve, për të cilat destinohet ushqimi përkatës, si dhe dozat e përdorimit;

e) data e prodhimit dhe afati kohor i përdorimit.

2. Për ushqimet në kontenierë, në etiketa shënohet:

a) informacioni, që kërkohet sipas pikës 1 plotësohet në një fletë të veçantë, e cila shoqëron mallin;

b) në pikën 1.ç shtohet vëllimi neto për ushqimet në gjendje të lëngshme.

Neni 6

Kalimi dhe kontrolli i ushqimeve

Ushqimet për blegtorinë, lëndët shtesë dhe parapërzierjet, që nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nuk lejohen të hyjnë ose të prodhohen në vend dhe/ose të qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Importuesit e ushqimeve për blegtorinë, për lëndë shtesë dhe për parapërzierje du

Neni 8

Inspektorët

1. Inspektimi i ushqimeve të blegtorisë kryhet nga inspektorët përkatës.
2. Inspektorët e ushqimeve të blegtorisë vendosin lejimin ose moslejimin e qarkullimit të mallit në bazë të rezultateve të analizave të kontrollit të një laboratorit të certifikuar.
3. Gjatë inspektimit, personat e autorizuar marrin mostra falas, në sasi të përcaktuara, sipas metodikave të miratuara për ekzaminim nga KUB-ja.
4. Në përfundim të inspektimit, inspektori i jep prodhuesit ose shpërndarësit certifikatën e cilësisë dhe të sigurisë dhe mban përgjegjësi ligjore.
5. Inspektorët për kontroll mbajnë sekret të dhënat e prodhimit ose të procesit teknologjik, të cilat i tregohen atij gjatë kontrollit.
6. Të gjitha subjektet janë të detyruara të mos pengojnë kryerjen e kontrollit nga personat e autorizuar nga ligji, në mjediset e punës dhe në vendet ku janë vendosur linjat teknologjike për prodhimin e ushqimeve për blegtorinë.

Neni 9

Fushat e veprimit të kontrollit

Kontrolli shtetëror i ushqimit të blegtorisë ushtrohet mbi:

- a) lëndët e para, shtesat, lëndët ndihmëse teknologjike, si dhe mbi produktet e gatshme nga pikëpamja e treguesve cilësorë të deklaruar dhe të miratuar;
- b) objektet, proceset, linjat dhe pajisjet që përdoren për prodhimin e ushqimeve nga pikëpamja teknologjike;
- c) kushtet e paketimit dhe të etiketimit;
- ç) kushtet teknologjike të manipulimit, transportit, ruajtjes;
- d) sistemin e kontrollit të cilësisë së prodhimit;
- dh) dokumentacionin tekniko-teknologjik.

Neni 10

Bllokimi i ushqimeve

Kur personi ose subjekti i autorizuar vëren se një pjesë e ushqimeve që tregtohet është shpërndarë në kundërshtim me atë që parashikon ky ligj dhe/ose aktet nënligjore në zbatim të tij, nxjerr urdhrin e bllokimit të mallit.

Brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të urdhrit për bllokimin e mallit, ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit ose personi i autorizuar prej tij, duhet të nxjerrë urdhrin për të asgjësuar mallin ose për të moslejuar përdorimin e tij. Asgjësimi i mallit të bllokuar bëhet me akt, në bashkëpunim me inspektorin sanitar shtetëror dhe inspektorin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Neni 11

Qendrat e referencës

Qendrat e referencës së kontrollit cilësor të ushqimeve për blegtorinë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- Instituti i Kërkimeve Zooteknike
- Instituti i Kërkimeve Veterinare

Në varësi metodike dhe shkencore të këtyre instituteve janë të gjithë laboratorët lokalë, sipas përkatësisë.

Neni 12

Komisioni i të ushqyerit të blegtorisë

Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe i Ushqimit ngrihet dhe funksionon Komisioni i të Ushqyerit

të Blegtorisë (KUB). Ky komision drejtohet nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit ose i deleguari i tij.

Komisioni i të Ushqyerit të Blegtorisë punon në bazë të statutit dhe të rregullores përkatëse, e cila miratohet nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Neni 13

Detyrat e Komisionit të të ushqyerit të blegtorisë

Detyrat e Komisionit të të ushqyerit të blegtorisë janë:

- t'i propozojë Ministrisë së Bujqësisë dhe i Ushqimit ndryshimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor të prodhimit, përpunimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të ushqimeve të blegtorisë;
- të përcaktojë standardet ushqimore dhe kategoritë e tyre;
- të përcaktojë kufijtë e lejit të përdorimit të lëndëve shtesë, biostimulatorëve dhe preparateve kurative;
- të rishohë dhe të miratojë sistemet e vlerësimit të ushqimeve;
- të përcaktojë metodat zyrtare që do të përdoren për vlerësimin e ushqimeve;
- të përcaktojë kushtet paraprake që duhet të plotësojnë subjektet prodhuese dhe mënyrën e licencimit të tyre, si dhe kërkesat për gjendjen e mjediseve e të pajisjeve që lidhen me këto subjekte;
- të përcaktojë rregullat për asgjësimin e mallit të bllokuar.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Shpërndarja ose tregtimi i ushqimeve të blegtorisë kur etiketimi nuk është konform përcaktimeve të nenit 5 të këtij ligji.
2. Shpërndarja ose tregtimi i ushqimeve të blegtorisë, që nuk përputhet me të dhënat e treguara në etiketë, sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij ligji.
3. Prodhimi, përpunimi, importimi, tregtimi dhe rezervimi i ushqimeve të veçanta të blegtorisë, i ushqimeve të përziera dhe i lëndëve shtesë, të ndryshme nga ato që parashikohen në këtë ligj, me përjashtim të rasteve për nevoja eksperimentale që do të lejohen me urdhëresë të veçantë nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.
4. Prodhimi ose tregtimi i ushqimeve të blegtorisë që përmbajnë lëndë të dëmshme, të ndaluara për përdorim sipas nenit 3, pika 7 të këtij ligji dhe akteve nënligjore.
5. Prodhimi dhe tregtimi i ushqimeve të blegtorisë në të cilat përmbajtja e lëndëve shtesë dhe e lëndëve të dëmshme kalojnë kufijtë e lejuar të përdorimit të tyre sipas rregullores përkatëse.
6. Tregtimi i ushqimeve të blegtorisë, që kanë kaluar afatin kohor të përdorimit të shënuar në etiketën shoqëruese.

Neni 15

Sanksionet

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji, nga organet e kontrollit jepen gjobat si më poshtë:

1. Për shkeljet e parashikuara në nenin 14, pikat 1 dhe 2 jepet gjoja nga 50 - 100 mijë lekë.
2. Për shkeljet e parashikuara në nenin 14, pikat 3, 4, 5 dhe 6 jepet gjoja nga 150 - 300 mijë lekë.

Neni 16

Procedurat e kundërvajtjes administrative

drejtori i organit të kontrollit në ministrinë përkatëse.

3. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 17

Organet e kontrollit të ushqimeve për blegtorinë për zbatimin e detyrës së ngarkuar me ligj, kërkojnë ndihmë nga organet e ruajtjes së rendit, policisë doganore dhe tatimore.

Neni 18

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 19

Çdo ligj ose dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2235, datë 19.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**